UDHËZIM
Nr.25, datë 2.8.2010

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 9.5.2008 "PËR VEPRIMTARINË E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pikat 1 dhe 2, dhe 50, pika 4, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 7 shtohen pikat 7.1 dhe 7.2, si më poshtë:

"7.1 Për institucionet e arsimit të lartë që procesin mësimor të ciklit të parë nuk e kanë të organizuar në leksione dhe seminare, 1 (një) orë mësimore konvertohet me koeficientin 1.4.

7.2 Për programin e doktoratës, 1 (një) orë mësimore (60 minutëshe) konvertohet me koeficientin 2.5.".

2. Pas pikës 12.1 shtohet pika 12.2, si më poshtë:

"12.2 Pagesa për udhëheqjen e doktoraturës është 90 orë mësimore/vit dhe për oponencë teze doktorature është 20 orë mësimore/oponencë.".

II. Ngarkohen institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj